

Lënda: Kthim Përgjigje

Qendra "Res Publica",
person juridik i regjistruar në gjykatë
me Vendimin nr. 604 dt. 13.04.2010,
përfaqësuar nga Z. Dorian Matlija

Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë
Email: qendra.respublica@gmail.com

Lidhur me Objektin: Kërkese per informacion dhe venien ne dispozicion të dokumentacionit lidhur me kërkesën e një qytetari për tu informuar në lidhje me: Inspektimet, dëmtimet, konstatimet, masat e marra për mbrojtjen e lumit Erzen, si dhe cilat kompani janë të licensuara për shfrytëzimin e inerteve të lumit Erzen, ju bejmë me dije si vijon:

Drejtoria e Inspektim-Kontrollit(DIK), në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit(AKM), gjatë Monitorimit, Verifikimit dhe kontrollit që ka bërë përgjatë shtratit të lumit Erzen,në mbështetje të legjislacionit në fuqi, ka konstatuar ndërhyrje në shtratin e lumit dhe hedhje, depozitim materialesh inerte në brigje, veprime të cilat përbëjnë kundravajtje administrative dhe për pasojë ka marrë këto masa ndaj subjekteve,duke vendosur këto dënime:

- Subjekti "A..... I....."shpk, ka kryer ndërhyrje dhe gërmime në shtratin e lumit Erzen dhe si pasojë, ndaj tijë është marrë masë Administrative, dënim me gjobë në masën 1000000 lekë.
- Subjekti " B.... E....." shpk, ka kryer hedhje, depozitim të materialeve Inerte, të dala nga prishja e subjekteve ndërtimore në bregun e lumit Erzen dhe si pasojë, ndaj tijë është marrë masë Administrative, dënim me gjobë në masën 1000000 lekë.
- Në Dijeninë tonë dhe mbështetur në legjislacionin në fuqi, nuk ka kompani që janë të licensuara për shfrytëzimin e inerteve në lumin Erzen.